

**VENDIM**  
**Nr. 714, datë 12.10.2016**

**PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT  
E NJERIUT, DATË 10.5.2016, PËR ÇËSHTJEN “MIRELA SINANI KUNDËR  
SHQIPËRISË DHE GJASHTË KËRKESA TË TJERA”  
(KËRKESA NR. 21634/15)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave,

**VENDOSI:**

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.5.2016, për çështjen “Mirela Sinani kundër Shqipërisë dhe gjashtë kërkesa të tjera” (aplikimi nr. 21634/15), në lidhje me dëmin pasuror e jopasuror, si dhe kostot e shpenzimet, sipas listës së kërkesve dhe vlerave financiare të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij, duke e përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim, sipas shtojcës 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, sipas shtojcës 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të kërkesve, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.5.2016, për çështjen “Mirela Sinani kundër Shqipërisë dhe gjashtë kërkesa të tjera” (aplikimi nr. 21634/15), bërë përfundimtar në datën 2.6.2016.

4. Pagimi i shumës së depozituar, sipas pikës 3, të këtij vendimi, në favor të kërkesve në çështjen “Mirela Sinani kundër Shqipërisë dhe gjashtë kërkesa të tjera” (aplikimi nr. 21634/15), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit tremujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi vlerat financiare të parashikuara në shtojcën 1, të këtij vendimi, paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efekti financiar i parashikuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**

SHTOJCA 1  
LISTA E KËRKUESVE/VLERAT MONETARE TË PËRFITIMIT

| Nr. | Emri dhe numri i<br>kërkesës | Emri, mbiemri i<br>përfituesit | Dëmi pasuror e jopasuror, si dhe<br>shpenzimet gjyqësore |
|-----|------------------------------|--------------------------------|----------------------------------------------------------|
| 1.  | Sinani, nr. 21634/15         | Mirela Sinani                  | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |
| 2.  | Haxhiu, nr. 21693/15         | Pëllumb Haxhiu                 | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |
| 3.  | Rama, nr. 25430/15           | Mirvete Rama                   | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |
| 4.  | Kaci, nr. 27429/15           | Kosta Kaci                     | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |
| 5.  | Shqopa, nr. 27438/15         | Kujtim Shqopa                  | 1 700 (një mijë e shtatëqind) euro                       |
| 6.  | Berberi, nr. 30171/15        | Pranvera Berberi               | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |
| 7.  | Naska, nr. 30175/15          | Matilda Naska                  | 1 100 (një mijë e njëqind) euro                          |